

Mëso të jesh një çikë më pak i përsosur

Në jetën e një perfeksionisti nuk ka vend për gabime, ndaj kur kjo ndodh, zhgënjehet nga vetja dhe nga të tjerët. A ke prirjen për të qenë i përsosur? Nëse po, provo sugjerimet e mëposhtme.

1 IDENTIFIKO PROBLEMIN

Përcakto se në ç'fushë të jetës je më i prirur të kërkossh përsosmëri.



NË SHKOLLË

(Bëhesh keq fare nëse nuk merr notën më të mirë.)



NË SHTËPI

(Kur rregullon dhomën, çdo gjë duhet të jetë perfekte. Mërzitesh nëse ndonjë gjë nuk është fiks aty ku duhet.)



NË MIQËSI

(S'je hiq tolerant ndaj gabimeve të të tjerëve, sidomos të atyre me të cilët je shumë i lidhur.)



TË TJERA

Tani mendo për fushën e jetës që identifikove.
Si e shfaq prirjen për përsosmëri në këtë fushë?

2 NDRYSHO DREJTIM

Bibla thotë se «mençuria nga lart është . . . e arsyeshme».

(Jakovi 3:17) Si mund të tregohesh më i arsyeshëm në atë çka pret nga vetja (ose nga të tjerët), në fushën e jetës që identifikove më parë?

► Në vend që

► Mund



3 ZGJIDH NJË SHKRIM

Cili shkrim përshatet më mirë me situatën tënde?

☐

‘Ji modest ndërsa ecën me Perëndinë tënd.’
—Mikea 6:8.

☐

«Po t’i mbaje sytë te fajet, o Jah, o Jehova,
kush do të mbetej në këmbë?»—Psalmi 130:3.

☐

«Nuk ka asnjë njeri të drejtë në tokë, që vazhdon
të bëjë [gjithmonë] të mirën.»—Eklisiastiu 7:20.

☐

«Të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e kanë arritur
lavdinë e Perëndisë.»—Romakëve 3:23.

☐

«Arsyetueshmërinë tuaj le ta njohin të gjithë.»
—Filipianëve 4:5.

Si mund të të ndihmojë shkrimi
që zgjodhe, për të luftuar maninë
për përsosmëri?

4

ZGJIDH NJË MODEL PËR TË IMITUAR

Kë mund të zgjedhësh *ti* si shembull arsyetueshmërie dhe pse?



«Kur e kuptoj se po tregohem perfeksioniste, përpiqem të sjell ndër mend njerëz që i admiroj. Një arsye pse i admiroj është se më bëjnë të ndihem rehat. Dua që të tjerët të mendojnë po njësoj për mua dhe kjo më bën më të vendosur t'i rezistoj prirjes për përsosmëri.»
—Ana.



5

VENDOS NJË SYNIM

Ç'synim mund të vendosësh për të luftuar maninë për përsosmëri?

«Nëse diçka nuk shkon sipas planit, thuaj vetes se bërë më të mirën. Përqendrohu te gjërat pozitive. Çdo dështim shihe si mundësi për të mësuar.»—Kera.